

KIS Interpretimi 7

Futja në Përdorim e Euros

Referencat

- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 10 *Ngjarje pas datës së bilancit* (sipas rishikimit në 2003)
- SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit* (sipas rishikimit në 2003)

Çështja

- 1 Që prej 1 Janar 1999, që daton me hyrjen në fuqi të Bashkimit Monetar dhe Ekonomik (BME), monedha euro operon me të drejta të plota dhe kurset e konvertimit të euro-s me monedhën lokale të vendeve pjesëmarrëse do të jenë pakthyesmërisht fikse, d.m.th rreziku i diferencave që vijnë nga konvertimi me këto monedha eliminohen që nga kjo datë e në vazhdim.
- 2 Çështje mbetet zbatimi i SNK 21 në transformimin e monedhave lokale të Shteteve Anetare të Bashkimit European në Euro (“transformimi”).

Konsensusi

- 3 Kërkesat e SNK 21 në lidhje me përkthimin e transaksioneve në monedhën e huaj dhe pasqyrave financiare të operacioneve në vende të huaja duhet të zbatohen saktësisht gjatë transformimit. E njëjta llogjike është e zbatueshme edhe në përcaktimin e kurseve të këmbimit për vendet që i bashkohen BME-së në periudha të mëvonshme.
4. Kjo nënkupton që në veçanti:
 - (a) Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj që vijnë si rezultat i transaksioneve duhet të vazhdojnë të përkthehen në monedhën funksionale me kursin e mbylljes. Çdo diferencë që rezulton nga konvertimi duhet menjëherë të njihet si e ardhur apo shpenzim, përveç rastit kur një njësi ekonomike do të vazhdojë të zbatojë politikën kontabël ekzistuese në lidhje me fitim/humbjet nga konvertimi të lidhura me mbrojtjet nga rreziku i valutës së një transaksioni të parashikuar;
 - (b) diferencat e konvertimit të akumuluar nga përkthimi i pasqyrave financiare të një operacioni të kryer jashtë vendit duhet të vazhdojë të klasifikohen si kapital neto dhe të njihen si e ardhur apo shpenzim vetëm në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të vlerës neto të investimit në operacionin e kryer jashtë vendit; dhe
 - (c) diferencat e konvertimit që rezultojnë nga përkthimi i detyrimeve në monedhën e vendit pjesëmarrës nuk do të përfshihen në vlerën kontabël neto të aktiveve të lidhura.

Data e marrëveshjes

Tetor 1997

Data e hyrjes në fuqi

Ky interpretim hyn në fuqi më 1 qershor 1998. Ndryshimet në politikën kontable duhen përfshirë në përputhje me kërkesat e SNK 8.